



Parlamenti im



Deputeti im



Studime dhe Raporte



Pyet Deputetin



Gjithçka mbi ligjet



Seancat Plenare



Komisionet
Parlamentare



Deklarimet e Pasurise



Grate Deputete



Grupet Parlamentare



Institucionet e
Pavaruara



Sondazhe dhe
vleresime

**INSTITUTI I
STUDIMEVE
POLITIKE**

ANKETIM ME DEPUTETET

TIRANE 2019



Kingdom of the Netherlands



Kingdom of the Netherlands



Projekti realizohet nga Instituti i Studimeve Politike www.isp.com.al me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta (Holandës). Në funksion të projektit është realizuar aplikacioni online www.deputetim.al ku reflektohen të dhënat e vazhdueshme të monitorimit. Ky është raporti i dytë i monitorimit në kuadër të projektit.

BOTUES

Instituti i Studimeve Politike

SPECIALE

ANKETIM ME DEPUTETËT

MBI PËRCEPTIMIN E TYRE NDAJ FUNKSIONIT, ROLIT TË KUVENDIT,
NJOHJEN E LEGJISLACIONIT, BILANCIN E AKTIVITETIT TË TYRE,
RAPORTEVE ME PARTINË POLITIKE DHE ELEKTORATIN,
RAPORTET E KUVENDIT ME INSTITUCIONET E TJERA KUSHTETUESE,
SI DHE TË DHËNAT MBI VETË DEPUTETËT,
FORMIMIN, FAMILJEN, BESIMIN DHE KARRIERËN E TYRE



1. ANKETIMI ME DEPUTETËT E KUVENDIT

Gjatë vitit 2018 Instituti i Studimeve Politike zhvilloi një anketim me deputetët e Kuvendit lidhur me kualifikimin e tyre, nivelin e angazhimit politik, vlerësimin për politikën dhe aktivitetin parlamentar, njohjen e rregullores dhe ligjit dhe sugjerimet për përmirësim në të ardhmen.

Qëllimi i anketimit është të masë perceptimin mbi problematikat e mësipërme nga këndvështrimi i vetë deputetëve, si dhe duke i ballafaquar gjetjet me sondazhe në të ardhmen me qytetarët, të bëjë analizën nga dy këndvështrimet. Gjetjet e anketimit kanë vlerë këshilluese edhe për vetë axhendën e Kuvendit në fazën e ndërhyrjeve të nevojshme në Rregullore ose në Statusin e Deputetit, si dhe kanë vlerë për partitë politike si burimi kryesor i karrierës, ashtu edhe për median, qytetarët dhe grupet profesionale.

Të dhënat e marra nga përgjigjet e deputetëve u përpunuan nga stafi i ISP me qëllimin për të analizuar problematikat e ndryshme në parlament nga këndvështrimi parlamentar dhe për të sugjeruar përmirësime për të ardhmen. Materiali final u vendos të publikohej në kuadër të monitorimit të Kuvendit shtator-dhjetor 2018, edhe për shkak të boshllëkut të krijuar nga mungesa e opozitës dhe për pasojë, e pamundësisë për të vlerësuar të gjithë deputetët për aktivitetin e tyre parlamentar.

1.1. METODOLOGJIA

Stafi i ISP ia adresoi pyetësonin të gjitha grupeve parlamentare (në formë kolektive) dhe mbi 100 deputetëve (në komunikim nominal). Përgjigjet që erdhën nga grupet parlamentare ishin minimale, ndaj stafi i ISP u fokusua në punën e deputetëve në Komisione dhe në komunikimin online individual për të siguruar përgjigjet e mundshme për pyetësonin.

Në përfundim të procesit, i dhanë përgjigje të plotë pyetësonit 78 deputetë dhe përgjigje të pjesshme 11 deputetë. Në total u tërhoqën mendimet e 89 deputetëve, ose 63% e numrit të përgjithshëm të deputetëve. Nëse në listë hiqen ministrat (asnjë prej ministrave nuk u ftua të shprehej dhe ndaj nuk pati përfshirje në pyetësonin e ISP), atëherë përqindja e deputetëve që dhanë përgjigje është rreth 70%. Pjesë të përgjigjeve ishin deputetë të PS, PD, LSI dhe PDIU. Disa deputetë që përfaqësojnë kryetarët e partive të vogla, në tërësi nuk patën përgjigje pozitive, por në dy raste përgjigjesh, edhe ato ishin vetëm të pjesshme.

1.2. JASHTË POLITIKËS, DOMINOJNË JURISTËT DHE EKONOMISTËT

Të pyetur se cilat janë profesionet e tyre jashtë politikës, rezulton se dy kategoritë kryesore të profesioneve janë ekonomistët dhe juristët me nga 11.8%. Në vijim, kategoria e tretë kryesore është qenia biznesmen dhe marrja me biznes pas karrierës politike, ndjekur nga angazhimi si pedagog në universitete.

Deputetët e tjerë deklarojnë se kanë profesione specifike: si biologë, mësues, inxhinierë, oficerë policie, ekspertë turizmi, veterinerë, etj, kurse 2.9% e tyre deklarojnë se kanë angazhime në shoqërinë civile, angazhime që do ti ruajnë edhe në të ardhmen.



1.3. A JANË DEPUTETËT BESNIKË TË ZONËS ZGJEDHORE?

Deputetët që kishin më shumë se një mandat parlamentar u pyetën nëse më 2018 vijojnë të kenë të njëjtën bashki/njësi elektorale, që kanë pasur edhe në mandatin e tyre të parë parlamentar. Nga përgjigjet rezultoi se 29% e deputetëve kanë ndryshuar bashkinë/njësinë elektorale dhe 3% e shohin ndryshimin shkak të reformës territoriale 2014. Në tërësi, 32% kanë ndryshuar zonë dhe 68% theksojnë se vijojnë të jenë deputetë në të njëjtën bashki/njësi ku kanë fituar edhe mandatin e parë të karrierës së tyre. Nëse i referohemi direkt zonës elektorale brenda vetë bashkive/njësave, atëherë numri i deputetëve që kanë ndryshuar zonën është shumë më i madh.

Ndryshimi i zonave elektorale pas zgjedhjeve parlamentare është një dukuri që shpjegohet kryesisht me vendimmarrjet politike të kryesisë së sekretariatit të partive politike dhe një prej pasojave të sistemit elektorale proporcional, në të cilin qytetarët nuk votojnë deputetin por subjektin politik. Referuar të dhënave të zgjedhjeve parlamentare 2017, në fundin e vitit 2018 kur u realizua anketimi, rezultoi se 15% e drejtuesve kryesorë në listat e qarqeve (dy partitë e mëdha) kanë ndryshuar zonën elektorale në funksion të strategjive elektorale të partive. Shembull tipik është Kukësi dhe Dibra, dy qarqet më me shumë ndryshime.

NËSE KENI MË SHUMË SE NJË MANDAT NË PARLAMENT	PO	JO	TJETER
JENI NË TË NJËJTËN ZONË SI NË MANDATIN E PARË	68%	29%	3%
JENI NË TË NJËJTËN PARTI SI NË MANDATIN E PARË	92%	5%	3%

1.4. BESIMI FETAR, 65% ME IDENTITET TË QARTË FETAR

Më 2017 ISP pati publikuar të dhënat e besimit fetar të deputetëve. Në anketimin e zhvilluar direkt me deputetët më 2018, rezultoi se 65% e deputetëve deklarojnë pa problem identitetin e tyre fetar, ndërsa 35% deklarohen në forma mikse, ateistë ose besim fetar të përzier për shkak të besimeve të ndryshme fetare të prindërve të tyre dhe preferencave specifike personale.


Në pyetjen e këtyre të fundit për të identifikuar një besim fetar dominues për veten e tyre, përgjigjet ishin nga më të larmishmet, - që nga “mysliman liberal”, “i krishterë i konvertuar”, “protestan” dhe deri tek “feja e shqiptarit është Shqiptaria”.

1.5. DOMINUESE PËR DEPUTETË, FAMILJET ME 4 ANËTARË

Deputetët u pyetën mbi numrin e anëtarëve në familjen e tyre, në mënyrë që të bëhet një lidhje midis përgjegjësisë në familje dhe angazhimit si deputet.

Nga të dhënat rezultoi se mbi 52% e deputetëve kanë familje me katër anëtarë (bashkëshortë me dy fëmijë, ose me prindër që jetojnë së bashku). Familjet me më shumë se katër anëtarë zënë kuotën e dytë më të lartë, me 22.6%, familjet me 3 anëtarë zënë kuotën e tretë më të lartë me 10,2%, familjet e deputetëve me dy anëtarë zënë kuotën e katërt më të lartë me 8,8% të numrit të deputetëve të anketuar.





Së fundi, numri i familjeve të deputetëve me përgjigje të ndryshme (familje që jeton e ndarë për shkak të emigrimit, që është në proces gjyqësor për ndarje, që është në bashkëjetesë, etj) zë kuotën 5,5% të numrit të deputetëve. Fakti se pjesa më e madhe e familjeve të deputetëve janë me nga 4-5 ose më shumë anëtarë, do të thotë se mbi 75% e deputetëve janë familjarë dhe kanë persona të tjerë nën përgjegjësi.


1.6. DEPUTETËT: VETËM 35% KA PASUR POSTE NË PARTI PËRPARA ZGJEDHJES

Deputetët u pyetën nëse përpara hyrjes në parlament kanë pasur përvojë politike drejtuese në sektorë të ndryshëm, si në parti politike, në funksionet e qeverisjes vendore, në jetën publike apo në sektorin publik.

Nga përgjigjet e dhëna prej deputetëve rezulton se 35% e deputetëve kanë pasur përvojë angazhimi dhe drejtimi në partitë politike përpara hyrjes në parlament, - një kuotë shumë e vogël nëse merret parasysh fakti se qenia deputet është pozicioni i dytë më i lartë politik në një parti politike. Kuotë e të njëjtë kanë edhe deputetët që kanë pasur funksione drejtuese në qeverisjen lokale (të zgjedhur ose të emëruar), - kjo një e dhënë pozitive për nivelin e informacionit dhe ekspertizës që deputetët mund të kenë mbi problematikat e qeverisjes vendore në Shqipëri. përqindja e deputetëve që kanë pasur angazhime drejtuese publike në sektorë të ndryshëm, përfshirë drejtimi në institucione, në media, në OJF, botën akademike, etj, është relativisht më i ulët sesa dy kuotat e para, me vetëm 23.5% të të gjithë numrit të deputetëve.

Nga të dhënat e sektorëve të tjerë, ka prurje me angazhime drejtuese në universitete (2,9%), në gazetari (2,9%), drejtues në sektorin privat (10,5%), etj. Kuota më e lartë u përket deputetëve që kanë pasur poste dhe angazhime drejtuese në sektorin publik, sidomos në administratë dhe në fushën e shërbimeve, të drejtorive dhe sektorëve të tjerë publikë.


Fakti se ka më shumë prurje nga sektori administrativ e publik sesa nga sistemi i karrierës në partitë politike tregon se partitë politike të përfaqësuara në parlament kanë më shumë prirje promovimi për figura teknike sesa për figura të karrierës politike në fushatat elektorale.



1.7. 50% E BASHKËSHORTËVE TË DEPUTETËVE PUNOJNË NË SHTET

Deputetët u pyetën nëse bashkëshorti/bashkëshortja i/e tyre është ka angazhime politike dhe është i/e punësuar në shtet apo privat. Nga përgjigjet rezultoi se një e treta e deputetëve deklarojnë se bashkëshorti/bashkëshortja i/e tyre nuk ka angazhime në parti politike apo poste të ndryshme drejtuese politike, si dhe dy të tretat janë po ashtu jashtë politikës, por në angazhime të ndryshme publike. Vetëm 2.9% e konfirmojnë angazhimin e kundërt.

Lidhur me marrëdhëniet e punës, 8,8% e deputetëve deklarojnë se bashkëshorti/bashkëshortja i/e tyre janë të papunë, pra nuk kanë asnjë angazhim kontraktor punësimi në shtet apo në privat. Lidhur me angazhimet shtet – privat, rezultoi se dominues për bashkëshortët e deputetëve është punësimi në shtet (50%) ndaj 35% në privat. Punësimi në shtet është tipar i shprehur tek të gjithë deputetët, por me theks të veçantë tek deputetët e mazhorancës, ku përqindja në shtet arrin deri në 70% e të pyeturve, kurse punësimi në privat është kryesisht tregues për një pjesë të deputetëve të opozitës.




1.8. PREFERENCA PËR FËMIJËT? SHKOLLA JASHTË VENDIT DHE SHKOLLAT PRIVATE

Pyetja për angazhimin social e politik të bashkëshortëve është e lidhur me pyetjen për angazhimin social të fëmijëve të deputetëve (për ata që kanë fëmijë). Deputetët u pyetën nëse fëmijët e tyre mbi 14% janë me studime brenda ose jashtë vendit dhe se në dy rastet, dy të tretat e deputetëve refuzuan të japin informacion. Ndër ata që dhanë informacion rezultoi se 26,5% e deputetëve i kanë dërguar fëmijët e tyre në shkollat e mesme ose të larta brenda vendit dhe 17,6% i kanë dërguar fëmijët në shkolla jashtë vendit.

Lidhur me natyrën e shkollës, publike apo private, rezultoi se shumica e deputetëve që janë përgjigjur i kanë fëmijët e tyre në shkolla private (17,6%) ndaj atyre në shkollat publike (5,9%). Ndër përgjigjet e tjera deputetët dhanë variante të ndryshme alternative, si për shembull, një vit në shtet dhe dy vjet në privat, ose për ca kohë jashtë vendit, por më pas në shkollat brenda vendit, etj.

Në tërësi, pa rëndësinë e detajeve, tabloja e të dhënave nga deputetët tregon se preferencë mbetet dërgimi i fëmijëve në shkolla të mesme ose të larta private dhe se përqindja e atyre që i kanë dërguar fëmijët në shkolla jashtë vendit është relativisht shumë më e lartë sesa përqindja e popullsisë votuese.



1.9. KRITER KARRIERE? IDEOLOGJIA E NJEJTË ME ATË TË PARTISË

Një prej pyetjeve që lidhen me cilësinë e përfaqësimit politik në Shqipëri, ka të bëjë me motivet, për të cilat deputetët janë zgjedhur. Anketimi iu drejtua deputetëve për të marrë prej tyre argumentet dominuese mbi arsyet që ata besojnë se kanë influencuar më së shumti në zgjedhjen e tyre deputet.

Përqindjen më të lartë e ka marrë arsyetimi se deputetët janë ideologjikisht të njëjtë me partinë politike që i ka kandiduar dhe që përfaqësojnë. Kjo alternativë ka marrë miratimin e mbi dy të tretave të deputetëve të përfshirë në anketim.




Kategoria e dytë më e kuotuar është ajo e besimit nga deputetët se janë përzgjedhur nga vetë votuesit, - pavarësisht se sistemi aktual i votimit është me listë të mbyllur dhe votuesit nuk kanë mundësi të zgjedhin asnjë individ si deputet në parlament. kategoria e tretë më e kuotuar është “dëshira për të kontribuar” pavarësisht ideologjisë politike që përfaqëson partia dhe individi.

Një tipar i tillë zakonisht është në sistemet mazhoritare dhe jo në proporcionale, megjithatë përgjigjia e deputetëve tregon se ose një pjesë e tyre e besojnë vërtetë këtë alternativë ose kanë tendencën të shfaqen jo partiakë në funksionin e tyre parlamentar.

Kategoritë që lidhen me partinë, - besimi se deputeti është i vlefshëm në partinë e tij dhe se deputeti ndjehet i përmbushur me partinë e tij, - kanë kuota të njëjta vlerësimi, me vetëm 35% mbështetje.

Kjo do të thotë se shumica e deputetëve nuk e vlerësojnë veten si vlerë të veçantë në partinë e tyre politike dhe nuk mendojnë se partia e tyre politike ka forcën për të përmbushur aspiratat e deputetëve të zgjedhur. Së fundi, vetëm një numër minimal deputetësh pranojnë se janë zgjedhur deputet për shkak se kanë njohje personale me liderin politik / kryetarin e partisë dhe se besojnë tek ata.




Duke u bazuar në përvojën politike 2017-2018 (për deputetët e zgjedhur për herë të parë) dhe përvojën në vite në parlament për ata që kanë aty më shumë mandate përfaqësimi, deputetët u pyetën mbi vlerësimet e tyre mbi politiken dhe forcën e saj ndryshuese në shoqëri. Konkretisht, 90-92% e deputetëve mendojnë se përmes angazhimit në politike mund të ndryshohen gjerat në vend dhe se vetë deputetët kanë ende shumë për të dhënë në politikë.

Dy të tretat e deputetëve të anketuar mendojnë për veten e tyre se ndjehen të realizuar/përmbushur në synimet për të cilat ata hynë në politikë, - tregues i vetëvlerësimit të lartë për veten e tyre. Ndaj në alternativën nëse deputetët ndjehen të penduar që hynë në politikë, vetëm 11% konfirmojnë se janë të penduar, pra edhe të zhgënjyer, kurse pjesa tjetër prej 89% ndjehet komode dhe ka ambicie për të vijuar karrierën politike.



PAS PËRVOJËS SË DERITANISHME NË POLITIKË MENDONI SE:



Interesante është vlerësimi i deputetëve se rreth dy të tretat nuk bien dakord me vlerësimin se politika i ndryshon njerëzit dhe jo e anasjelltë, - një vlerësim i dukshëm për fuqinë e elektoratit dhe qytetarëve për të ndryshuar politikën dhe imponuar vendimmarrjet. Disa të dhëna të dala nga përgjigjet janë gjithashtu interesante. Për shembull, fakti se 44%e deputetëve janë të bindur se nuk kanë hapësirë për të ndryshuar gjërat në vend, pra se sistemi aktual përfaqësues nuk është funksional dhe kufizon hapësirën për reforma, si dhe të dhënat se 33% e deputetëve shprehen se ende nuk janë të përmbushur në synimet e tyre politike.

1.10. VLERËSIMI I DEPUTETËVE PËR NIVELIN E TYRE TË KUALIFIKIMIT, TRAJNIMIT DHE TË NEVOJAVE

Një set pyetjesh iu adresuan deputetëve lidhur me kapacitetet e tyre për kualifikim brenda parlamentit, për informacion, për trajnim, për angazhime në botime brenda kuadrit parlamentar, etj. Pyetjet e mëposhtme janë të rëndësishme për të kuptuar raportin e deputetëve me facilitetet që ofron vetë parlamenti. Nga të dhënat rezultojnë se:

- *vetëm një e treta e deputetëve janë frekuentues të arkivit dhe bibliotekës së Kuvendit;*
- *38% janë lexues të revistës së Kuvendit, e cila u jepet falas deputetëve;*
- *70% janë ndjekës të rregullt të Fletores Zyrtare ku botohen ligjet e miratuara nga vetë deputetët,*
- *88% janë ndjekës të rregullt të medias politike (gazeta dhe në TV),*
- *58% deklarojnë se janë ndjekës të ndonjë prej mediave të huaja kur shkruhet për Shqipërinë;*
- *64% deklarojnë se janë lexues të rregullt të librave politikë më në zë që botohen në Shqipëri;*
- *79% marrin pjesë rregullisht në trajnime, konferenca e seminare në Kuvend;*
- *41% janë angazhuar në shkrime të ndonjë artikulli në revista të ndryshme përfshirë atë të Kuvendit,*
- *85% janë pjesëmarrës në referime të ndryshme, brenda e jashtë vendit, si dhe*
- *Vetëm një e treta e deputetëve janë ndjekës të rregullt të mediave të ndryshme sociale*




Të dhënat janë interesante dhe meritojnë të testohen edhe në anketime të tjera periodike për të parë bazën e tyre reale dhe evoluimin gjatë viteve. Për shembull, drejtori i ISP është një prej anëtarëve të Bordit të Revistës “Kuvendi” dhe nga kjo njohje e afërt, konfirmon vetëm një numër minimal deputetësh, të cilët janë angazhuar dhe kanë botuar në këtë revistë gjatë viteve të fundit.

Fakti se vetëm pak deputetë botojnë, ndërkohë që ata deklarojnë se kanë botuar në përqindje të lartë, është tregues i të dhënave të pasakta të dhëna nga deputetët dhe i keqinterpretimit prej tyre të koncepteve “botim”, “referim”, etj. Për shembull disa deputetë kishin shënuar si referime edhe fjalimet e mbajtura në evenimente të ndryshme politike dhe elektorale të zonës së tyre, angazhim që de facto nuk përbën kontribut profesional dhe as shkencor.

MUNDËSITË / KAPACITETET / NEVOJAT E KUALIFIKIMIT PROFESIONAL	PO	JO	TJETER
JENI VIZITOR I RREGULLT I ARKIVIT DHE BIBLIOTEKËS SË KUVENDIT?	29,4	41,2	29,4
JENI NDJEKËS I RREGULLT I REVISTËS DHE BOTIMEVE TË KUVENDIT?	38,2	29,5	32,4
JENI NDJEKËS I RREGULLT I FLETORËS ZYRTARE DHE I VENDIMMARRJEVE TË NDRYSHME?	70,6	13,8	14,7
JENI NDJEKËS I RREGULLT I MEDIAS POLITIKE (MEDIA E SHKRUAR, TV)?	88,2	2,9	8,8
JENI NDJEKËS I RREGULLT I SHTYPIT TË HUAJ MBI SHQIPËRINË?	58,8	27,7	13,5
JENI LEXUES I RREGULLT I LIBRAVE POLITIKË BASHKËKOHORË?	64,7	5,9	29,4
JENI PJESËMARRËS I RREGULLT NË AKTIVITETE TRAJNIMI, KONFERENCA, SEMINARE?	79,4	5,9	14,7
KENI SHKRUAR ARTIKULL NË REVISTËN KUVENDI OSE REVISTE TJETËR SHKENCORË?	41,2	28,6	29,4
KENI FOLUR / LIGJËRUAR NË KONFERENCA /SEMINARE / AKTIVITETE BRENDA E JASHTË?	85,3	2,9	11,8
JENI PËRDORUES I RREGULLT I RRJETEVE SOCIALE?	32,4	22,8	42,8

1.11. PËRDORIMI I MEDIAVE SOCIALE NGA DEPUTETËT

Ndër një e treta e deputetëve që përdorin rregullisht rrjetet sociale ka deputetë që kanë akses dhe përvojë me të gjitha mediat kryesore sociale, siç ka deputetë me aktivitet vetëm në media të veçanta.



Deputetët u pyetën për të dhënë përgjigje dhe nga të dhënat, rezultoi se 66% e atyre që përdorin rrjetet sociale (pra e 32% të deputetëve) janë përdorues vetëm të Facebook, 25% janë përdorues të tri mediave sociale, - facebook, twitter dhe Instagram, 4% vetëm në twitter dhe 5% vetëm Instagramin.

1.12. 75% E DEPUTETËVE, VLERËSIM MAKSIMAL PËR RAPORTET MONITORUESE


Një set pyetjesh adresuar deputetëve lidhen me raportin midis grupeve monitoruese të ndryshme me fokus Kuvendin dhe vetë aktivitetin e deputetëve / Kuvendit. Pyetjes nëse monitorimet kanë qenë të sakta, 48% i vlerësojnë pozitivisht, 20% negativisht dhe 30% kanë vlerësim alternativ. Pyetjes vijuese nëse monitorimet dhe rezultatet e tyre kanë qenë të dobishme, 75% janë konfirmuese, një raport shumë i lartë pozitiv.

Në vlerësimin se raportet kanë ndikuar në rritjen e transparencë së Kuvendit, 58% janë konfirmues dhe vlerësues ndaj 16% të deputetëve që mendojnë ndryshe, ndërkohë që 9% kanë mendim alternativ. Rreth gjysma e deputetëve deklarojnë se raportet e monitorimit e kanë lehtësuar punën e tyre si deputetë, ndërkohë që 30% janë kritikë.

Në lidhje me fjalimet dhe angazhimin e deputetëve në to, rezultoi se 26% mendojnë se gara për të dalë mirë në raportet monitoruese ka rritur fiktivitetin e diskutimeve të deputetëve në seanca dhe në komisione, ndaj 45% që mendojnë ndryshe.

LIDHUR ME MONITORIMET QË I BËHEN KUVENDIT

■ PO ■ JO ■ TJETER



Pyetja e fundit lidhej me konkurrencën e deputetëve brenda grupit parlamentar për shkak të raporteve monitoruese. 28% e deputetëve mendojnë se raportet monitoruese kanë rritur konkurrencën e deputetëve brenda grupeve parlamentare, ndërkohë që 43% e deputetëve mendojnë se nuk kanë ndikuar në nivelin e konkurrencës. Në total 28% kanë mendim alternativ, përfshirë edhe dilemën në vlerësimin pozitiv apo kritik.



1.13. STATUSI, PËRFITIMET DHE SUGJERIMET

Një set tjetër pyetjesh lidhet me statutin e deputetit, me privilegjet, të drejtat dhe përfitimet në kuadër të tij. Kjo është një problematikë që shpesh krijon debate në publik, ndaj ISP e përfshiu në detaje në anketimin e tij ndaj Kuvendit. Mbi bazën e përgjigjeve të dhëna nga deputetët, të cilat në tërësi kishin përgjigje të prera dhe jo ekuivoke si dhe shumica absolute e tyre preferuan të përgjigjen, rezultoi se:

- **Mbi 82% kanë pasaportë diplomatike për bashkëshortët e tyre**
- **Mbi 85% kanë përfituar trajtim të rregullt financiar (dieta, honorare, etj)**
- **Mbi 55% kanë zyrë në dispozicion të ofruar nga Kuvendi**
- **Mbi 35% kanë kaluar makinë pa doganë për veten e tyre**
- **Mbi 52% kanë përdorur sallën VIP në Rinas në udhëtimet e tyre**
- **Mbi 92% mendojnë se rroga që marrin është e pamjaftueshme**
- **Mbi 44% janë kundër sistemit aktual të llogaritjes së rrogës nga Kuvendi**
- **Mbi 85% ankohet se rroga i pamundëson takime të rregullta elektorale**
- **Mbi 77% nuk i përballon dot shpenzimet me rrogën e deputetit**
- **Mbi 55% janë kundër penalizimit në rrogë në rast mungese në Kuvend**
- **Mbi 91% janë pro stafit teknik në dispozicion për deputetët në Kuvend**
- **Mbi 85% kërkojnë buxhet personal parlamentar për aktivitetet e tyre**

LIDHUR ME TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË SI DEPUTET	PO	JO	TJETER
A KENI PËRFITUAR PASAPORTË DIPLOMATIKE PËR VETEN E BASHKËSHORTIN/EN?	82,11	8,16	9,19
A KENI PËRFITUAR TRAJTIM FINANCIAR NGA KUVENDI (DIETA, HONORARE, ETJ)?	85,4	9,1	5,3
A KENI ZYRË NË DISPOZICION TË OFRUAR NGA KUVENDI?	55,9	35,3	8,7
A KENI KALUAR MAKINË PA DOGANË PËR VETEN TUAJ?	35,3	61,8	2,9
A KENI PËRDORUR SALLËN VIP NË AEROPORTIN E RINASIT?	52,9	44,1	2,9
A MENDONI SE RROGA E DEPUTETIT ËSHTË E MJAFTUESHME PËR PUNËN QË BËNI?	2,9	91,2	5,9
A MENDONI SE RROGA E DEPUTETIT DUHET NJËSUAR, JO E NDARË NË ZËRA?	44,1	29,4	25,5
A MENDONI SE RROGA E DEPUTETIT I LEJON TAKIME TË RREGULLTA ELEKTORALE?	5,4	85,7	8,8
A MENDONI SE RROGA E DEPUTETIT I PËRBALLON SHPENZIMET E NEVOJSHME?	16,6	77,9	5,4
A MENDONI SE RROGA DUHET KUFIZUAR NË RAST MUNGESË NË KUVEND?	35,8	55,9	8,2
MENDONI SE DEPUTETI DUHET TË KETË STAF TEKNIK TË PAGUAR NË DISPOZICION?	91,2	4,9	2,9
MENDONI SE DEPUTETI DUHET TË KETË BUXHET PERSONAL PËR AKTIVITETET?	85,8	7,9	5,9
A MENDONI SE PRAKTIKA E OSBE PËR ZYRA NË QARK KA QENË EFEKTIVE?	55,9	41,9	2,1



1.14. SHUMICA ABSOLUTE E DEPUTETËVE TË KËNAQUR ME PUNËN E VET

Një tregues i rëndësishëm i aktivitetit parlamentar është raporti i tyre me pritshmëritë e elektoratit dhe përgjegjësitë ligjore në funksion. Bazuar në këtë element të rëndësishëm ISP i pyeti deputetët për një set pyetjesh që lidhen me vlerësimin e bilancit të tyre parlamentar gjatë vitit 2017-2018. Rezultatet më domethënëse të përgjigjeve për këto pyetje janë si më poshtë:

- **Mbi 82% thonë se kanë përfaqësuar me dinjitet elektoratin / partinë**
- **Mbi 79% mendojnë se e kanë justifikuar besimin e elektoratit**
- **Vetëm 41% ndaj 45% deklarojnë rezultate mesatare në punën e tyre**
- **Mbi 55% deklarojnë se kanë pasur vështirësi në mbajtjen e premtimeve**
- **Vetëm 8-9% pranojnë se kanë dështuar në pritshmëritë ndaj tyre**
- **Mbi 20% nuk identifikojnë bilanc personal pune, por bilanc kolektiv (partia)**
- **Mbi 52% zotohen të kenë rezultate më të larta gjatë vitit 2018-2019**
- **Mbi 64% pranojnë se kanë mësuar nga kolegët e tyre më me përvojë në Kuvend**

SI E VLERËSONI PUNËN TUAJ PERSONALE GJATË 2017 - 2018?	PO	JO	TJETER
KAM PËRFAQËSUAR ME DINJITET ELEKTORATIN DHE PARTINË	82,4	14,7	2,9
KAM JUSTIFIKUAR BESIMIN E ELEKTORATIT DHE PRITSHMËRINË PUBLIKE	79,4	6,9	13,6
KAM PASUR REZULTATE MESATARE NË PUNËN TIME SI DEPUTET	41,2	45,8	12,8
KAM PASUR VËSHIRËSI TË MBAJ PREMTIMET DHE TË KRYEJ DETYRËN	55,8	14,8	29,4
KAM DËSHTUAR TË PËRMBUSH PRITSHMËRITË E ELEKTORATIT DHE PARTISË	8,8	57,6	33,5
NUK KAM BILANC PERSONAL, AKTIVITETI IM VARET NGA GRUPI/PARTIA	20,5	38,4	41,1
GJATË VITIT TJETËR DO TË KEM REZULTATE MË TË PREKSHME / LARTA	52,9	14,7	31,9
KAM PUNUAR SI DEPUTET DUKE MËSUAR NGA KOLEGËT MË ME PËRVOJË	64,7	18,1	17,1

5.16. DEPUTETËT: KRITIKAT QYTETARE JANË PARAGJYKUESE

Një set tjetër pyetjesh lidhet me raportet midis perceptimit të deputetëve për kritikën publike dhe me perceptimin e publikut ndaj deputetëve. Të pyetur mbi këto raporte, deputetët dhanë përgjigje, të cilat na ndihmojnë të rendisim gjetjet kryesore janë më poshtë.

Nga këto të dhëna rezulton se deputetët në tërësi nuk janë të familjarizuar me kritikën publike dhe nuk e pranojnë në tërësi perceptimin publik kritik ndaj tyre. Ata fajësojnë publikun mbi nivelin e ulët të besimit dhe nivelin e lartë të kritikave, ndërkohë që pranojnë se vetë deputetët bëjnë premtime jashtë mundësive reale të tyre për t'i mbajtur ato.



- **82% ankohen se publiku është paragjykses ndaj deputetëve**
- **60% mendojnë se perceptimi publik kritik ndaj tyre është i drejtë**
- **53% vlerësojnë se kritikën publike kanë qenë të pabazuara**
- **79% ankohen se qytetarët nuk i njohin kompetencat e deputetëve**
- **70% vlerësojnë se deputetët premtojnë jashtë kapaciteteve të tyre**
- **73% mendojnë se sulmohen pa të drejtë nga publiku**

LIDHUR ME PERCEPTIMIN PUBLIK MBI DEPUTETËT DHE RAPORTIN ME QYTETARËT:	PO	JO	TJETER
NDJENI SE PUBLIKU ËSHTË PARAGJYKUES NDAJ DEPUTETËVE?	82,4	5,8	11,6
NDJENI SE NDJESIA KRITIKE NDAJ ËSHTË NË TËRËSI E DREJTË?	59,3	32,4	8,3
NDJENI SE KRITIKAT E TYRE JANË TË PABAZUARA?	53,5	16,5	29,9
NDJENI SE QYTETARËT NUK NJOHIN KOMPETENCAT E DEPUTETËVE?	79,4	14,7	5,8
NDJENI SE DEPUTETËT PREMTOJNË MË SHUMË SESA MUND TË BËJNË?	70,6	8,8	20,6
NDJENI SE DEPUTETËT SULMOHEN PA TË DREJTË NGA PUBLIKU?	73,5	9,8	16,6

5.17. DEPUTETËT, RRETH 80% KËRKOJNË TRAJNIME VJETORE NGA KUVENDI

Deputetët u pyetën edhe për problematika që lidhen me asistencën që atyre iu ofrohet nga Kuvendi, nga partia e tyre politike dhe nga grupi parlamentar në ushtrimin sa më cilësor të funksionit të tyre parlamentar. Të dhënat me gjetjet kryesore janë të renditura më poshtë. Vlerësimi i përgjithshëm është se deputetët deklarojnë njohje të thelluar të Rregullores së Kuvendit dhe të Statutit të Deputetit, por në praktikë konstatohet mosrespektim i tyre dhe në shumë raste, edhe mos njohje e tyre. Deputetët marrin më shumë asistencë teknike e politike nga partia e tyre politike sesa nga Kuvendi dhe se kanë vlerësim kritik për aftësitë e këshilltarëve në grupet e tyre parlamentare. Ata kërkojnë trajnime të përvitshme parlamentare në lidhje me funksionin dhe problematikat e konstatuara në jetën parlamentare. Gjetjet kryesore janë si më poshtë:

- **97% deklarojnë se kanë njohuri të thelluara mbi Rregulloren**
- **94% kanë marrë kopje falas të rregullores dhe të ligjit mbi statusin**
- **75% kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme mbi funksionet / rolin**
- **82% kanë marrë pjesë në trajnime të ofruara nga partia e tyre politike**
- **79% kërkojnë trajnime vjetore nga Kuvendi mbi problematikat parlamentare**
- **64% konfirmojnë se janë asistuar rregullisht nga stafi i Kuvendit**
- **8% deklarojnë se janë refuzuar në kërkesën për asistencë nga stafi i Kuvendit**
- **61% vlerëson se Kuvendi ka staf të aftë për të ofruar ekspertizë**
- **82% janë asistuar rregullisht në punën e tyre nga grupi i tyre parlamentar**
- **76% janë asistuar rregullisht në punën e tyre nga partia e tyre politike**
- **29% thonë se këshilltarët e grupit janë më shumë politikanë sesa ekspertë**



NË LIDHJE ME AKTIVITETIN E DEPUTETËVE DHE TË PARLAMENTIT	PO	JO	TJETER
A KENI NJOHURI TË THELLUARA MBI RREGULLOREN DHE MBI STATUSIN E DEPUTETIT?	97,1	2,9	0
A KENI NË DISPOZICION KOPJE FALAS TË RREGULLORES DHE TË STATUSIT?	94,1	5,7	0,2
A KENI PASUR TRAJNIME NGA KUVENDI MBI FUNKSIONET DHE ROLIN E DEPUTETIT?	75,4	24,5	0,1
A KENI PASUR TRAJNIME NGA PARTIA JUAJ MBI FUNKSIONET DHE ROLIN E DEPUTETIT?	82,4	11,8	5,8
A NDJENI NEVOJËN TË KETË TRAJNIME VJETORE MBI PROBLEMATIKA PARLAMENTARE?	79,4	11,8	8,8
A JENI ASISTUAR RREGULLISHT PËR LIGJE NGA STAFI I KUVENDIT?	64,7	25,5	9,8
A JENI REFUZUAR PËR ASISTENCË LIGJORE NGA STAFI I KUVENDIT?	8,8	79,4	11,8
A MENDONI SE STAFI I KUVENDIT KA KAPACITETE TË OFROJË ASISTENCËN E DUHUR?	61,7	29,4	8,8
A JENI ASISTUAR RREGULLISHT NGA STAFI POLITIK I GRUPIT TUAJ PARLAMENTAR?	82,3	8,8	8,8
A JENI ASISTUAR RREGULLISHT NGA STAFI POLITIK I PARTISË (NË PARTI JO NË KUVEND)?	76,4	17,5	5,9
A MENDONI SE KËSHILLTARËT E GRUPIT TUAJ JANË MË SHUMË POLITIKË SE EKSPERTË?	29,1	59,9	10,9

5.18. SHUMICA KËRKOJNË VENDIMMARRJE ME VOTIM ALTERNATIV NË GRUP

Deputetë mbledhen në grupe parlamentare pothuajse çdo javë për të debatuar mbi axhendën politike dhe parlamentare. Në kushtet kur mazhoranca parlamentare është njëherësh edhe mazhorancë në qeveri axhenda kushtëzohet dhe imponohet nga qeveria, kurse opozita tradicionalisht gjatë dekadës së fundit e përdor mbledhjen e grupit për vendimmarrjet më të rëndësishme politike. Dy format e mbledhjes nuk ndikojnë në vlerësimin e rolit dhe përgjegjësisë së posaçme që kanë në partitë respektive kryetarët e grupeve parlamentare. Drejtuesit e grupeve kanë peshë specifike politike dhe publike dhe janë burime referimi për median, politikën, partnerët ndërkombëtarë, etj.

Në lidhje me raportet e deputetëve me grupin e tyre parlamentar ISP ndërtoi një set pyetjesh bazë, të cilat na ndihmojnë të zbulojmë e vlerësojmë më mirë problematikat “brenda familjes politike”. Nga gjetjet kryesore të anketimit rezultoi se:

- **Mbi 11% vlerësojnë se kryetari i grupit ka vendimmarrje selektive**
- **Rreth 6% mendojnë se vendimmarrja në grup është formale**
- **Mbi 55% kërkojnë votim alternativ për vendimmarrjet në grupe**
- **Rreth 6% mendojnë se kryetari i grupit ka më shumë pushtet sesa duhet**
- **Mbi 41% mendojnë se duhet votëbesim të kryetarit të grupit në çdo fillim sesioni**
- **Mbi 38% vlerësojnë se deputetët e vjetër janë më të preferuar se të rinjtë**
- **Mbi 26% mendojnë se deputetët e rinj nuk kanë ofruar ndonjë risi**
- **Një e treta e deputetëve vlerëson se ka dallime cilësore mes deputetëve gra e burra**
- **Mbi 69% vlerësojnë se disa deputetë në grup kanë më shumë pushtet se të tjerët**



NË LIDHJE ME GRUPET PARLAMENTARE DHE CILËSINË NË PËRFAQËSIM	PO	JO	TJETER
A MENDONI SE KRYETARI I GRUPIT MERR VENDIME SELEKTIVE PËR DEPUTETET NË GRUP?	11,8	79,4	8,3
A MENDONI SE VENDIMARRJA NË GRUP ËSHTË FORMALE NGA KRYETARI?	5,9	85,3	8,8
A MENDONI SE VENDIMARRJA NË GRUP DUHET TË JETË GJITHNJË ME VOTIM ALTERNATIV?	55,9	29,4	14,7
A MENDONI SE KRYETARI I GRUPIT KA MË SHUMË PUSHTET SESA DUHET TË KETË NË GRUP?	5,9	82,4	11,8
A MENDONI SE KRYETARI I GRUPIT DUHET VOTËBESUAR ÇDO FILLIM SESIONI TË KUVENDIT?	41,2	44,1	14,7
A MENDONI SE DEPUTETËT E VJETËR JANË MË TË PREFERUAR SE TË RINJTË?	38,2	52,9	8,7
A MENDONI SE DEPUTETËT E RINJ NUK KANË OFRUAR RISI NË PARLAMENT?	26,4	64,7	8,8
A MENDONI SE KA DALLIME CILËSORE PUNE MIDIS GRAVE E BURRAVE NË PARLAMENT?	32,3	64,7	2,9
A MENDONI SE DISA DEPUTETË KANË MË SHUMË PUSHTET SE DISA TË TJERË NË GRUP?	69,5	23,5	6,9

5.19. RRETH 15% E DEPUTETËVE PRANOJNË VOTIME NË KONFLIKT PERSONAL INTERESI

Të dhënat e nxjerra nga ky set pyetjesh ndihmojnë të kuptojmë një sërë problematikash që kërkojnë përmirësim ose zgjidhje më optimale në Kuvend. Konkretisht, zyrtarisht Kuvendi ka raportuar 0 raste të konfliktit të interesit të deputetëve në vendimarrjen e tyre, ndërkohë që në anketim vetë deputetët deklarojnë se 14% e tyre kanë pasur raste të konfliktit personal të interesit me ligje të caktuara për të cilat kanë diskutuar dhe kanë votuar. Po ashtu, gati një e treta e deputetëve deklarojnë se nuk janë në dijeni të kostos financiare të akteve që vetë votojnë, dhe rreth një e treta nuk është në dijeni për nivelin e zbatimit të akteve që miratojnë përfshirë edhe rezultat parlamentare.

Deputetët në masën absolute deklarojnë se janë në dijeni të peticioneve që vijnë në Kuvend, dhe gjysma e tyre janë në dijeni të kalendarit të punimeve mujore të bashkisë/qarkut apo të mbledhjes së Këshillit të Ministrave, por nga monitorimi aktiv i parlamentit rezulton se këto të dhëna janë të pamundura. Axhenda e Këshillit të Ministrave nuk është publike dhe formësohet në rrugë të mbyllur administrative dhe se 95% e bashkive dhe qarqeve të Shqipërisë i kanë kthyer përgjigje zyrtare ISP-së se nuk kanë informuar asnjëherë deputetët për kalendarin e tyre të punimeve mujore.

- **Mbi 88% janë të informuar mbi ligjet dhe aktet e Kuvendit**
- **Mbi 88% janë të informuar mbi kalendarin e punës në Kuvend**
- **Mbi 73% janë të informuar mbi peticionet adresuar Kuvendit**
- **Mbi 38% nuk janë të informuar për kalendarin e punës së bashkisë/qarkut**
- **Mbi 47% nuk janë të njohur me axhendën e mbledhjeve të qeverisë**
- **Mbi 73% janë të informuar mbi botimet e Kuvendit**
- **Mbi 70% informohen mbi trajtimin financiar në Kuvend**
- **Mbi 47% nuk kanë bërë asnjë propozim në axhendë/Kuvend**
- **Mbi 41% janë informuar mbi ecurinë e nismave të tyre ligjore**
- **Mbi 61% janë të informuar mbi ecurinë e kërkesave në Kuvend**



- **Mbi 70% janë të informuar mbi aktivitetet e Kuvendit**
- **Rreth 30% nuk janë të informuar mbi kostot financiare të ligjeve që votojnë**
- **Një e treta nuk janë të informuar mbi ecurinë/zbatimin e ligjeve që votojnë**
- **Mbi 29% nuk janë të informuar mbi ecurinë e rezolutave të miratuara**
- **Mbi 29% nuk janë të informuar mbi rastet e konfliktit të interesit në Kuvend**
- **Mbi 14% deklarojnë se kanë pasur raste personale të konfliktit të interesit**

NË LIDHJE ME RREGULLOREN DHE PERGJEGJËSITË QË BUROJNË PREJ SAJ	PO	JO	TJETER
A JENI INFORMUAR SIPAS RREGULLORES PËR LIGJET DHE AKTET E KUVENDIT?	88,2	5,9	5,9
A JENI INFORMUAR SIPAS RREGULLORES PËR KALENDARIN E PUNËS NË KUVEND?	88,2	2,9	8,8
A JENI INFORMUAR SIPAS RREGULLORES PËR PETICIONET ADRESUAR KUVENDIT?	73,5	17,6	8,8
A JENI INFORMUAR SIPAS LIGJIT ME KALENDARIN MUJOR TË BASHKISË/QARKUT TUAJ?	50	38,2	11,8
A JENI INFORMUAR SIPAS LIGJIT ME AXHENDËN E MBLDHEJEVE TË QEVERISË?	44,1	47,1	8,8
A JENI INFORMUAR SIPAS RREGULLORES ME BOTIMET E KUVENDIT?	73,5	14,7	11,8
A JENI INFORMUAR ME DETAJE TË TRAJTIMIT TUAJ FINANCIAR NGA KUVENDI?	70,6	14,7	14,7
A KENI RAST KUR KENI FUTUR NJË NISMË TUAJËN NË AXHENDËN PARLAMENTARE?	38,2	47,1	14,7
A JENI INFORMUAR SIPAS RREGULLORES ME ECURINË E NISMAVE TUAJA LIGJORE?	41,2	14,7	44,1
A JENI INFORMUAR SIPAS RREGULLORES ME ECURINË E KËRKESAVE TUAJA NË KUVEND?	61,7	14,7	23,5
A JENI INFORMUAR ME AKTIVITETIN E INSTITUCIONIT TË KUVENDIT?	70,5	14,7	14,7
A JENI INFORMUAR SIPAS LIGJIT ME KOSTOT FINANCIARE TË LIGJEVE QË KALOJNË?	58,7	29,4	11,8
A JENI INFORMUAR ME ECURINË/ZBATUESHMËRINË E LIGJEVE QË JU MIRATONI?	51,8	32,4	15,7
A JENI INFORMUAR ME ECURINË/ZBATUESHMËRINË E REZOLUTAVE QË MIRATONI?	52,9	29,4	17,6
A JENI INFORMUAR SIPAS LIGJIT ME RASTET E KONFLIKTIT TË INTERESIT NË KUVEND?	52,9	29,4	17,6
A KENI PASUR RAST TË DEKLARONI KONFLIKTIN TUAJ TË INTERESIT ME NJË AKT LIGJOR?	14,7	67,6	17,6

5.20. RRETH 12% E DEPUTETËVE PRANOJNË VOTIMIN E LIGJEVE PA I KUPTUAR ATO

Në ushtrimin e funksionit parlamentar merr rëndësi edhe raporti i deputetëve me integritetin e tyre personal në votimin e ligjeve dhe aktivizimin politik, raportet me median dhe me publikun, me të drejtat dhe me mjedisin e sigurt dhe të përshtatshëm për të ushtruar funksionet e tyre. Të dhënat më të rëndësishme të këtij seti pyetjesh janë si më poshtë.

Në të dhënat e nxjerra nga përgjigjet e deputetëve rezultojnë se ka një 10-11% raste kur deputetët kanë votuar ligje dhe akte pa i kuptuar ato, apo jashtë vullnetit të tyre personal si deputet. Gjithashtu një e treta e deputetëve deklarojnë se janë fyer personalisht nga kolegët në Kuvend, 35% deklarojnë se u janë cenuar të drejtat e tyre parlamentare dhe se 23% iu është hequr emri nga lista e diskutimeve në seancë pa miratimin paraprak të tyre.



Nisur nga mënyra sesi funksionon parlamenti, heqja e emrave nga lista e diskutimeve është kryesisht rol që e merr kryetari i grupit parlamentar, pavarësisht se çdo deputet ka të drejtë të flasë sipas Rregullores. E dhënë tjetër me interes është fakti se shumica e deputetëve janë pro një kanali televiziv dedikuar Kuvendit, por janë kritikë me projektin për largimin e gazetarëve nga prezenca e tyre në komisionet e Kuvendit.

- **64% kanë pasur rast të përfaqësojnë Kuvendin jashtë vendit**
- **76% kanë pasur rastin të jenë relator ligjesh apo aktesh në Kuvend**
- **11% deklarojnë se kanë votuar ligje / akte pa i kuptuar mirë ato**
- **17% deklarojnë se kanë votuar ligje/akte kundër vullnetit të tyre**
- **32% deklarojnë se kanë votuar ligje pa konsultim paraprak me partinë**
- **32% deklarojnë se janë ndjerë të fyer personalisht nga kolegë deputetë**
- **35% deklarojnë se u janë cenuar të drejtat e tyre parlamentare**
- **23% deklarojnë se u është imponuar dorëheqja nga lista e diskutimit në seancë**
- **64% deklarojnë se janë ndjerë të pafuqishëm për t'i ndryshuar gjërat**
- **55% deklarojnë se kanë pasur rast kur partia u ka mbështetur një nismë**
- **72% janë pro që Kuvendi të ketë një TV të dedikuar aktivitetit të tij**
- **52% janë kundër kufizimeve të aksesit për gazetarët në komisione**
- **64% mendojnë se Kuvendi nuk ka buxhet të mjaftueshëm për rolin e tij**
- **55% mendojnë se Kuvendi nuk ka asistencë të mjaftueshme për deputetët**
- **41% mendojnë se sistemi elektronik i Kuvendit është i besuar e funksional**

NË LIDHJE ME MIRË-FUNKSIONIMIN PARLAMENTAR	PO	JO	TJETER
A KENI PASUR RAST TË PËRFAQËSONI KUVENDIN NË AKTIVITETE NDERKOMBËTARE?	64,7	23,5	11,8
A KENI PASUR RAST TË JENI RELATOR I LIGJEVE NË KOMISION OSE NË SEANCË?	76,5	14,7	8,8
A KENI PASUR RAST TË KENI VOTUAR NJË LIGJ PA E KUPTUAR MIRË ATË?	11,8	79,4	8,8
A KENI PASUR RAST TË KENI VOTUAR NË KUVEND KUNDËR VULLNETIT TUAJ?	17,8	76,5	5,9
A KENI PASUR RAST TË KENI VOTUAR PA KONSULTIM ME PARTINË TUAJ?	32,4	58,8	8,8
A KENI PASUR RAST KUR JENI NDJERË I FYER NGA NDONJË KOLEG DEPUTET?	32,4	55,9	11,8
A KENI RAST KUR JENI NDJERË I CENUAR NË TË DREJTAT PARLAMENTARE?	35,3	58,5	5,9
A KENI PASUR RAST KUR JU ËSHTË IMPONUAR DORËHEQJA NGA FJALIMI NË KUVEND?	23,5	67,6	8,8
A KENI RAST KUR JENI NDJERË I PAFUQISHËM PËR T'I NDRYSHUAR GJËRAT?	64,7	23,5	11,7
A KENI RAST KUR PARTIA JUAJ KA MARRË PARASYSH NJË AKT TË INICIUAR NGA JU?	55,9	35,3	8,8
A MENDONI SE KUVENDI DUHET TË KETË NJË TV TË DEDIKUAR PËR AKTIVITETET E TIJ?	72,5	21,6	5,9
A MENDONI SE DUHET TË KETË AKSES TË KUFIZUAR PËR GAZETARËT NË KOMISIONE?	44,1	52,9	2,9
A MENDONI SE KUVENDI KA BUXHET TË MJAFTUESHËM PËR FUNKSIONIMIN E TIJ?	17,6	64,7	17,7
A MENDONI SE KUVENDI KA ASISTENCË TË MJAFTUESHME TEKNIKE PËR DEPUTETËT?	32,4	55,9	11,7
A MENDONI SE KUVENDI KA SISTEM ELEKTRONIK TË BESUESHËM DHE EFEKTIV?	41,2	32,4	26,4



5.21. SHUMICA E DEPUTETËVE KËRKOJNË FORCIM TË ROLIT TË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

Në vlerësimin për Komisionet parlamentare dhe aktivitetin e deputetëve në to, anketimi synoi të marrë perceptimet e deputetëve për efektivitetin e vetë komisioneve dhe më pas elementë teknikë e politikë të rëndësishëm që ndihmojnë të nxjerrin në pah raste pozitive ose problematika në funksionimin e tyre. Sic rezulton nga gjetjet specifike, deputetët në tërësi kërkojnë një ridimensionim të rolit dhe funksionit të Komisioneve parlamentare, më shumë kompetenca dhe buxhet, më shumë vëmendje dhe prioritet, si dhe sugjerojnë transparencë më të madhe, rol më të madh dhe përgjegjësi më të mëdha për institucionin e komisioneve parlamentare. Nga të dhënat e anketimit rezultoi se:

- **70% mendojnë se Komisionet duhet të kenë më shumë staf teknik**
- **73% mendojnë se Komisionet duhet të kenë buxhet të pavarur**
- **81% mendojnë se Komisionet duhet të kenë buxhet për kërkime**
- **76% mendojnë se Komisionet duhet të kenë më shumë kompetenca kontrolli**
- **73% kërkojnë më shumë vëmendje në seanca ndaj vendimeve të Komisioneve**
- **76% sugjerojnë rol më aktiv të Komisioneve në kontrollin kushtetues**
- **64% mirëpresin idenë që mbledhjet të bëhen edhe në qytete të tjera**
- **85% sugjerojnë transmetim live të mbledhjeve të komisioneve**
- **67% vlerësojnë se mbledhjet e Komisioneve janë më me rëndësi se seancat**
- **73% janë pro rritjes së aksesit të qytetarëve për pjesëmarrje në komisione**
- **85% mendojnë se vetëm një pakicë deputetësh është aktive në mbledhje**
- **91% mendojnë se sprova reale për deputetët janë komisionet, jo seancat**
- **91% e shohin vendimmarrjen në Komision më cilësore sesa në seanca**
- **55% kërkojnë më shumë kompetenca për kryetarët e komisioneve**
- **46% mendojnë se deputetët janë në komisione jo sipas aftësisë së tyre**
- **47% mendojnë se pagesa për punën në Komision është diskriminuese**

VLERËSIMI PËR KOMISIONET PARLAMENTARE: ROLIN E FUNKSIONIN	PO	JO	TJETER
A MENDONI SE KOMISIONET PARLAMENTARE DUHET TË KENË MË SHUMË STAF TEKNIK?	70,6	17,6	11,8
A MENDONI SE KOMISIONET PARLAMENTARE DUHET TË KENË BUXHET TË PAVARUR?	73,5	11,8	14,7
A MENDONI SE KOMISIONET DUHET TË KENË BUXHET PËR STUDIME/ RAPORTE?	81,3	5,9	11,8
A MENDONI SE KOMISIONET DUHET TË KENË MË SHUMË KOMPETENCA KONTROLLI?	76,5	8,8	14,6
A MENDONI SE VENDIMET E KOMISIONEVE DUHET TË KENË MË SHUMË ROL NË SEANCA?	73,5	11,8	14,7
A MENDONI SE KOMISIONET DUHET TË JENË MË AKTIV NË KONTROLLIN KUSHTETUES?	76,5	5,9	17,6
A MENDONI SE MBLEDHJET E KOMISIONEVE MUND TË BËHEN EDHE NË QYTETE TË TJERA?	64,7	23,5	11,8
MENDONI SE MBLEDHJET E KOMISIONEVE DUHET TË JENË LIVE NË FAQEN E KUVENDIT?	85,3	10,3	4,4
MENDONI SE MBLEDHJET E KOMISIONEVE KANË MË SHUMË VLERË SE SEANCA PLENARE?	67,6	23,5	8,9
MENDONI SE QYTETARËT NDJEKIN MË SHUMË SEANCA SESA MBLEDHJET E KOMISIONEVE?	73,5	20,6	5,9
A MENDONI SE VETËM NJË PAKICË DEPUTETËSH ËSHTË AKTIVE NË KOMISIONE?	85,3	11,8	2,9



A MENDONI SE SPROVA PROFESIONALE E DEPUTETIT ËSHTË KONTRIBUTI NË KOMISION?	91,2	5,9	2,9
A MENDONI SE VENDIMARRJA NË KOMISIONE ËSHTË MË PROFESIONALE SE NË SEANCË?	91,1	5,9	2,9
A MENDONI SE KRYETARËT E KOMISIONEVE DUHET TË KENË ROL MË VENDIMARRËS?	55,9	32,7	10,8
A MENDONI SE DEPUTETËT JANË ANËTARË NË KOMISIONE SIPAS AFTËSISË SË TYRE?	50	46,7	3,3
A MENDONI SE PAGESA MBI BAZËS MBLLEDHJESH NË KOMISION ËSHTË DISKRIMINUESE?	47,1	41,2	11,7

5.22. DEPUTETËT: DUAM MË SHUMË LIGJE, MOCIONE DHE INTERPELANCA

Në pyetjet adresuar vlerësimeve për drejtimin aktual të Kuvendit dhe sugjerimeve për përmirësime në të ardhmen, përfshirë edhe futjen e praktikave të disa vendeve të tjera (p.sh, disa vende evropiane zhvillojnë një javë seanca të përqendruara në 1 ose 2 muaj dhe më pas deputetët angazhohen me zonat e tyre) deputetët dhanë vlerësimet e tyre. Në disa prej pyetjeve, si vlerësimi për drejtimin aktual të Kuvendit, ndarja e deputetëve është sipas linjave partiake. Në pyetje si sugjerimi për seanca të përqendruara, por edhe për një sërë çështjes me rëndësi, si nevoja për më shumë mocione, interpelanca, seanca pyetjesh, më shumë nisma ligjore dhe komisione hetimore, etj, midis deputetëve të palëve të ndryshme politike nuk ka diferenca në linja partie. Ndër gjetjet kryesore janë:

- **32% janë kundër idesë të ketë më shumë seanca plenare në javë**
- **64% janë kundër praktikës së seancave të përqendruara 1 javë/muaj**
- **82% sugjerojnë se deputetët duhet të kenë më shumë nisma ligjore**
- **70% janë pro vlerësimit të argumenteve në ligjet e kthyera nga Presidenti**
- **64% janë kundër dorëheqjes së kryetarit nëse GJK provon vendime antikushtetuese**
- **59% e deputetëve kanë vlerësim pozitiv për drejtimin e Kuvendit nga kryetari**
- **29% mendojnë se kryetari duhet të ketë më shumë kompetenca**
- **61% sugjerojnë më shumë mocione besimi/mosbesimi në Kuvend**
- **85% sugjerojnë më shumë seanca pyetjesh dhe interpelanca në Kuvend**
- **55% sugjerojnë më shumë komisione hetimore efektive në Kuvend**

VLERËSIM PËR DREJTIMIN E KUVENDIT DHE SFIDAT E TIJ	PO	JO	TJETER
A MENDONI SE KUVENDI DUHET TË KETË MË SHUMË SE NJË SEANCË PLENARE NË JAVË?	32,4	63,8	3,8
MENDONI SE DO ISH MË PRODUKTIVE QË SEANCAT TË BËHEN 1 JAVË RRESHT PËR MUAJ?	23,5	64,7	11,8
A MENDONI SE KUVENDI/DEPUTETËT DUHET TË KENË MË SHUMË NISMA LIGJORE?	82,9	5,9	10,8
MENDONI SE DEKRETET E KTHYERA TE PRESIDENTIT DUHEN TRAJTUAR MBI ARGUMENTET?	70,6	14,7	14,7
A MENDONI SE KUVENDI DUHET TË KETË MË SHUMË MOCIONE BESIMI/MOSBESIMI?	61,8	24,9	12,8
A MENDONI SE KUVENDI DUHET TË KETË MË SHUMË INTERPELANCA / SEANCA PYETJESH?	85,3	8,9	5,8
A MENDONI SE KUVENDI DUHET TË KETË MË SHUMË KOMISIONE HETIMORE EFEKTIVE?	55,9	32,4	11,7
A MENDONI, KUR NGA PROVOHET SE KA LIGJE JOKUSHTETUESE KRYETARI TË DORËHIQET?	23,5	64,7	11,8
A MENDONI SE KRYETARI PO E DREJTON NË MËNYRË TË DREJTË KUVENDIN?	59,4	34,7	5,7
A MENDONI SE KRYETARI DUHET TË KETË KOMPETENCA MË TË MËDHA NË KUVEND?	29,4	50,1	20,4



MBI INSTITUTIN E STUDIMEVE POLITIKE

Instituti i Studimeve Politike (www.isp.com.al) është një organizatë e shoqërisë civile që vepron në fushën e demokratizimit dhe shtetit të së drejtës. Drejtor Ekzekutiv aktual është Prof. Afrim Krasniqi. ISP është e fokusuar në monitorimin e institucioneve demokratike, si dhe në hartimin e raporteve / analizave profesionale mbi problematika specifike politike me interes për qytetarët, shoqërinë dhe partnerët ndërkombëtarë. Pjesë e ISP janë ekspertë të njohur të zhvillimeve politike dhe të drejtësisë, të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të marrëdhënieve publike. ISP publikon vazhdimisht raporte monitoruese.

DISA NGA PROJEKTET KRYESORE TE REALIZUARA VITET E FUNDIT NGA ISP:

- Database www.deputetim.al mbi monitorimin e Kuvendit të RSH (2017-2020)
 - Monitorim të standardeve të etikës dhe Konfliktit të Interesit në parlament (2019-2020)
 - Monitorim të përdorimit të burimeve shtetërore në fushatë elektorale (2019-2020)
 - Database www.vota.al mbi votën dhe subjektet zgjedhore 1991-2017
 - Database online www.muzeumemories.info Shqipëria në periudhën komuniste
 - Database www.politike.al mbi partitë politike, zgjedhjet, organizimin e tyre, 2016-2017
 - Monitorim të reformës në drejtësi (nga 2016 dhe në vijim)
 - Monitorimin e ligjit të dekriminalizimit (studimi me gjetjet publikuat më 2018)
 - Monitorimin e demokracisë së brendshme në partitë politike (nga 2015). Raporte vjetore periodike
 - Monitorimin e reformës zgjedhore dhe komentat (broshurë) mbi ligjin “Mbi partitë politike”
 - Monitorimi i përfaqësimit të grave në partitë politike (2017) dhe në zgjedhjet lokale 2015
 - Monitorim i zonave zgjedhore të riskut dhe të përfshirjes së elementëve të inkriminuar 2015-2019.
 - Monitorim i qeverisë me ministra teknikë dhe botim profesional me gjetjet (2018)
 - Monitorim të Kuvendeve Kombëtare të partive kryesore. Anketime dhe raporte mbi gjetjet
 - Monitorim të çështjeve që lidhen me emigracionin / diasporën (nga 2018 në vijim)
 - Monitorimin e ligjit mbi të drejtën e informimit (nga 2014 dhe në vijim)
 - Monitorim të ligjit mbi qeverisjen vendore dhe efektet me ndarjen e re (nga 2016 dhe në vijim)
- ❖ Raporti do të shpërndahet në rrugë elektronike dhe të printuar të gjithë deputetëve në parlament, partive politike parlamentare, partnerëve të ISP, ekspertëve të angazhuar, si dhe mediave kryesore.
 - ❖ Të gjitha publikimet e ISP që lidhen me projekte kombëtare e ndërkombëtare (libra, studime, policy paper, raporte, etj) jepen falas për çdo të interesuar, si dhe publikohen në faqen zyrtare të ISP në formë të përmbledhur
 - ❖ Për çdo interes, sugjerim apo informacion, mund të kontaktoni në çdo kohë ISP përmes adresës zyrtare, e-mailit, faqes së internetit, adresave të ISP në rrjetet sociale, etj.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Parlamenti dhe përfaqësimi : anketim, monitorim dhe problematika : shtator - dhjetor 2018 / Afrim Krasniqi ; Instituti i Studimeve Politike. – Tiranë : ISP, 2019

ISBN 978-9928-4418-6-7

1.Parlamenti shqiptar 2.Monitorime 3.Raporte
328(496.5) “2018” (047)



www.isp.com.al
www.deputetim.al